



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE



KOMISIONERI

ilirjan.celibashi@cec.gov.al
www.cec.org.al

RELACION

PËR PROJEKT RREGULLOREN “PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT DHE ZHVILLIMIT TË SEANCAVE TË KAS”

Në zbatim të nenit 16, pika 6 dhe neni 20, pika 1, germa “d” të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, është përgatitur projektregullorja “Për mënyrën e funksionimit dhe procedurat e shqyrtimit të çështjeve nga Komisioni Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS), në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.

Kjo rregullore hartohet në kuadër të përmbushjes së detyrave të përcaktuara në nenin 16 dhe 21 të Kodit Zgjedhor, dispozita të cilat krijojnë një arkitekturë të re të administratës zgjedhore me krijimin e 3 organeve drejtuese duke përcaktuar ndër të tjera edhe detyrën e miratimit të rregullores për mënyrën e funksionimit dhe procedurat e shqyrtimit të çështjeve të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Projektregullorja e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, përbëhet nga 52 nene, strukturuar në 6 Krerë, të trajtuara si më poshtë:

Kreu I-rë – Përmban dispozita të përgjithshme si qëllimi, objekti, baza ligjore dhe parimet mbi të cilat udhëhiqet vendimmarrja e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve. Në këto dispozita identifikohen fusha e veprimit të rregullores si edhe baza ligjore dhe parimet mbi të cilat do të mbështetet funksionimi dhe veprimtaria e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve gjatë ushtrimit të kompetencave që i ngarkon Kodi Zgjedhor.

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të detajuara mbi organizimin dhe funksionimin e seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve si edhe rregullat mbi koordinimin e veprimtarisë administrative me Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kreu II-të- në përmbajtjen e tij ka 5 nene të cilat reflektojnë rregullime mbi përbërjen dhe kompetencat e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Neni 3 identifikon Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve si organ kolegjal të përbërë nga 5 anëtarë. Neni 4, përcakton kompetencat e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve të cilat janë një transpozim korrekt i dispozitave të nenit 21 të Kodit Zgjedhor. Në këtë dispozitë në paragrafin e tretë të tij parashikohen sipas përcaktimeve të nenit 21 të Kodit Zgjedhor mënyra e marrjes së vendimeve të këtij organi.

Nenet 5 dhe 6 përcaktojnë të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve përfshirë të drejtën për akses në informacion, për kushte të përshtatshme për të ushtruar veprimtarinë, të drejtën për t'u njohur me rendin e ditës dhe materialet e mbledhjeve të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve. Ato janë një përshtatje korrekte të detyrave që ushtrohen në kuadër të përmbushjes së të drejtave të tyre përcaktuara në nenin 21, paragrafi i dytë i Kodit Zgjedhor. Gjithashtu afatet për njohjen me materialet e seancave dhe rendin e ditës janë përcaktuar në përputhje me nenin 131 dhe 132, paragrafi 4 i Kodit Zgjedhor. Neni 6 ka saktësuar detyrimet që u rrjedhin anëtarëve të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve nga neni 12, paragrafi 6 i Kodit Zgjedhor.

Neni 7 identifikon administratën e Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si strukturën administrative përgjegjëse për mbështetjen dhe asistimin e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Kreu III – Nga pikëpamja strukturore kreu përbëhet nga 2 seksione. Në seksionin e parë janë parashikuar dispozitat që kanë të bëjnë me të drejtat e ankimit, formën dhe përmbajtjen e ankimit, ndërsa seksioni i dytë përmban procedurat e regjistrimit të ankimimeve dhe shortin. Seksioni i dytë përcakton rregulla të detajuara për të gjithë ciklin e ankimit, duke filluar me regjistrimin e ankimimeve në një regjistër të posaçëm, caktimin e seancës së përgatitjes së shortit, zhvillimin e shortit për përcaktimin e relatorit të çështjeve, dhe zhvillimin e tij.

Në këtë seksion për shkak të transpozimit korrekt dhe përshtatjes me ndryshimet reja ligjore të parashikimeve të Kodit Zgjedhor, dhe në mungesë të parashikimeve ligjore për një drejtues të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, kemi sjellë një mekanizëm të balancuar për caktimin e seancës së shortit për anëtarin relator, mekanizmin e vetëmbledhjes së Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, zhvillimin e tij dhe përcaktimin e relatorit që do të thërrasë seancën për shqyrtimin e çështjeve dhe drejtimin e seancave që do të zhvillohen në të njëjtën ditë. Këto parashikime reflektojnë frymën e ligjit sipas të cilit të gjithë anëtarët e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve janë të barabratë në ushtrimin e detyrave dhe funksioneve dhe nuk shprehet në lidhje me drejtimin e këtij organi, në dallim nga Rregullatori ku ligjvënësi ka parapëlqyer të parashikojë shprehimisht mbi drejtimin e tij.

Në seksionin e parë të këtij kreu, janë përcaktuar:

Veprimet procedurale të palëve që Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve kryen në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe aktet e nxjerra në zbatim të tij si edhe me Kodin e Procedurave Administrative dhe Kodin e Procedurës Civil, të parashikuara në nenin 8 të Rregullores.

Neni 9 përcakton të drejtën e ankimit në KAS dhe cilat vendime mund të ankimohen duke iu referuar Kodit Zgjedhor. Të drejtat e përcaktuara në këtë nen janë transpozime të sakta nga dispozitat e nenit 124, nenit 124/1 dhe nenit 124/4 të Kodit Zgjedhor (KZ) duke përcaktuar Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve si organin përgjegjës, që shqyrton ankimimet sipas përcaktimeve në nenin 21 të Kodit Zgjedhor.

Duke qene se KAS investohet ose nga ankimimet e subjekteve që kanë interes legjitim për vendimmarrjen apo mosveprimet e KZAZ dhe Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, si dhe nga

kërkesat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për sanksione dhe masa administrative, janë parashikuar dy forma të ndryshme të kërkesave ankimore.

Neni 10 përcakton formën dhe përmbajtjen e kërkesave ankimore në periudha zgjedhore, referuar përcaktimeve të nenit 126 dhe 127, paragrafi 2, i Kodit Zgjedhor.

Në seksionin e dytë janë parashikuar dispozitat që kanë të bëjnë me regjistrimin e ankimeve dhe organizimi i shortit.

Në nenin 11 është përcaktuar forma dhe përmbajtja e Regjistrit të ankimeve administrative referuar përcaktimeve të nenit 127 të Kodit Zgjedhor, duke e ndarë nga kërkesat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për sanksione administrative të normuar në një dispozitë të veçantë në kreu IV, seksioni II, neni 35.

Neni 12 përcakton rregulla për caktimin e seancës së shortit, neni 13 përmban rregulla për vetëmbledhjen e KAS dhe caktimin e seancës për përgatitjen e shortit, ndërsa në mungesë të përcaktimeve ligjore neni 14 përcakton mekanizmin për mënyrën e zhvillimit të shortit dhe detyrat për relatorin e parë që të thërrasë seancën vijuese për shqyrtimin e ankimeve.

Me qëllim ndarjen e barabartë të ngarkesës së relatorëve është parashikuar mekanizmi shpërndarës që me përfundimin e raundit të parë të tërheqjes së goglave, që në raundin e dytë anëtarët e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve sipas rendit alfabetik zbritës do të tërheqin një nga goglat që ndodhen në enë deri në shterimin e tyre. Gjithashtu është përcaktuar instrumenti për mbledhjen e seancës për të gjitha çështjet e shortuara, duke ngarkuar relatorin e përzgjedhur për shqyrtimin e kërkesës ankimore të parë në renditje si zyrtarin përgjegjës për organizimin e seancës vijuese ku do të bëhet shqyrtimi i kërkesave ankimore të shortuara.

Kreu IV përmban rregulla për procedurat e shqyrtimit të ankesave, dhe kërkesave të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Ai është ndarë në dy seksione. Në seksionin e parë janë përcaktuar procedurat e shqyrtimit të Ankimeve.

Neni 15 ngarkon relatorin e çështjes që do të shqyrtohet e para të organizojë seancën e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, si dhe përmbajtjen e rendit të ditës sipas parashikimeve të nenit 14. Gjithashtu është parashikuar mekanizmi i efikasitetit administrative që, për ankesa të paraqitura pas hedhjes së shortit deri në momentin e zhvillimit të seancës të përfshihet në rendin e ditës hedhja e shortit për kërkesat ankimore të regjistruara pas këtij momenti.

Neni 16 deri në nenin 19 janë përcaktuar rregulla që lidhen me veprimet paraprake si deklarimin e kushteve të konfliktit të interesit nga ana e anëtarëve për çështjen që trajtohet duke iu referuar nenit 30 të Ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe ligjit 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar; verifikimi i ekzistencës së elementeve formale të ankimit, si dhe verifikimi i elementeve që kanë lidhje me kompetencën, legjitimitetin dhe respektimin e afateve ligjore nga ankuesi si dhe dispozitën që parashikon bashkimin e kërkesave ankimore, sipas përcaktimeve të nenit 130, neni 131 dhe neni 132 të Kodit Zgjedhor duke transpozuar këto dispozita.

Neni 20 identifikon palët në shqyrtimin administrativ duke transpozuar saktësisht nenin 133 të Kodit Zgjedhor, ndërsa neni 21 përcakton rregulla për veprimet që kryhen në shqyrtimin administrativ duke saktësuar organet e reja në përshtatje me përcaktimet e nenit 134 të Kodit Zgjedhor.

Nenet 22 deri në nenin 23 sanksionojnë rregulla për çeljen e seancës, paraqitjen e pretendimeve dhe kërkimit të provave si dhe duke transpozuar përkatësisht nenet 135 dhe 136 të Kodit Zgjedhor.

Neni 24, përmban rregulla për detyrimin e organeve të tjera për të vënë në dispozicion prova, dhe është një transpozim i nenit 137 të Kodit Zgjedhor. Në këtë dispozitë është rregulluar edhe mekanizmi i kërkimit të provave nëpërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Neni 25 përcakton procedurat për këqyrjen e materialit zgjedhor sipas përcaktimeve të nenit 138 të Kodit Zgjedhor.

Neni 26 sanksionon rregullat për marrjen, disponimin e fakteve të njohura botërisht pa kryer verifikime të mëtijshme nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve duke transpozuar në mënyrë korrekte nenin 139 të Kodit Zgjedhor.

Nenet 27 – neni 29, përcaktojnë rregulla për paraqitjen e prapësimeve ndaj provave, deklarin e mbylljes së hetimit administrativ dhe tërheqjen e / ose heqjen dorë nga pretendimet pa marrë vendim KAS. Këto rregulla janë transpozuar saktësisht sipas përcaktimeve të neneve 140 – 142 të Kodit Zgjedhor.

Neni 30 identifikon llojet e vendimeve që merr KAS pas shqyrtimit të ankimeve duke iu referuar përcaktimeve të nenit 143 të Kodit Zgjedhor dhe vendos afatet për marrjen e tyre. Neni 31 përmban formën e vendimeve të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve sipas përcaktimeve të nenit 144 të Kodit Zgjedhor.

Neni 32 ka parashikuar që për rastet e Ankimeve ndaj vendimeve të tij në Kolegjin Zgjedhor administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përfaqëson KQZ-në duke paraqitur aktet, provat, prapësimet dhe konkluzionet referuar procesverbalit të seancës.

Nenet 33 përmbajnë rregulla për arkivimin e dokumentacionit të seancave për shqyrtimin e ankimeve, ruajtjen dhe administrimin e tyre.

Seksioni II, përmban rregulla për procedurat e shqyrtimit të kërkesave të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Neni 34 përcakton të drejtat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të vënë në lëvizje Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve sipas përcaktimeve të germave “d” dhe “dh” të paragrafit 1 të nenit 21 të Kodit Zgjedhor.

Neni 35 është përcaktuar forma dhe përmbajtja e Kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për Sanksione dhe / ose Masa administrative referuar përcaktimeve të Kodit të

Procedurave Administrative dhe Ligjit 10279, datë 20.05.2020 “Për kundërvajtjet administrative”.

Neni 36 përcakton krijimin e regjistrave për Sanksioneve administrative dhe për masat disiplinore si dhe përcakton mekanizmin e njoftimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, anëtarëve të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve për përgatitjen e seancës së shortit.

Neni 37 referon mekanizmin e caktimit të seancës për përgatitjen dhe zhvillimin e shortit sipas përcaktimeve të neneve 13 – 15 të kësaj rregulloreje. Neni 38 përcakton afatet për shqyrtimin e sanksioneve administrative apo vendosjes së masave disiplinore, referuar nenit 17 të Ligjit 10279 “Për kundërvajtjet administrative”.

Neni 39 përmban referenca ligjore për rastet e deklarimit të pamundësisë ligjore kur anëtari i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve gjendet në kushte të konfliktit të interesit, sipas përcaktimeve të nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative. Kjo dispozitë kërkon që për të gjitha rastet e pengesave të parashikuara të zbatohen dhe ndiqen parashikimet e nenit 16 të kësaj rregulloreje. Neni 39 detyron anëtarët e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve që të mos jenë relatorë dhe mos jenë pjesë e vendimmarrjes mbi një ankesë në rastet e konfliktit të interesit.

Neni 40 përcakton rregulla për shqyrtimin administrativ.

Neni 41 referon procedurat parashikuara nga ligji 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” për shqyrtimin e kërkesave të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për masa disiplinore dhe sanksione.

Nenet 42 dhe 43 përmbajnë rregulla dhe detyrimin e organeve publike që rrjedhin nga dispozitat e nenit 137 të Kodit Zgjedhor të vejnë në dispozicion provat Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve dhe përfundimin e procedurës administrative.

Neni 44 parashikon afatet e përfundimit të procedurës administrative referuar Ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Neni 45 përmban të dhënat e përmbajtjes së vendimeve të KAS-it për shqyrtimin e kërkesave të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në përmbushje të kritereve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 46 përcakton formën e vendimeve të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve në referencë të nenit 99 të Ligjit 44/2015, si dhe rregulla për zbardhjen dhe njoftimin e tij.

Neni 47 ka parashikuar që kundrejt vendimeve të KAS-it bëhet ankim në gjykatë. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përfaqëson KQZ-në duke paraqitur aktet, provat, prapësimet dhe konkluzionet referuar procesverbalit të seancës.

Nenet 48 dhe 49 përmbajnë rregulla për arkivimin e dokumentacionit të seancave për shqyrtimin e kërkesave të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ruajtjen dhe administrimin elektronik të tyre.

Kreu V - përmban një dispozitë që përcakton rregulla për administrimin e regjistrave duke përcaktuar Sekretarin e Përgjithshëm si nëpunësi që do të miratojë modelet e regjistrave.

Kreu VI – përmban dispozita të fundit.

Neni 51 sanksionin të drejtën e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve të zhvillojë seancat online në raste të masave të jashtëzakonshme duke garantuar të drejtën për akses në këto sisteme nga palët, ndërsa neni 52 parashikon hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje dhe publikimin në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe botimin në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.

Në hartimin e kësaj rregulloreje është marrë në konsideratë edhe përvoja e operimit të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përgjatë trajtimit të ankesave në periudhat zgjedhore, bazuar në problematikat dhe përvojën e krijuar ndër vite.

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Ilirjan CELIBASHI

